



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KËSHILLI

Nr. 5263/Prot.

Pogradec, më 23 . 11 .2022

VENDIM  
NR. 132, DATË 22 . 11 .2022  
PËR  
"MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË BASHKINË  
POGRADEC"

Në mbështetje të nenit 113, pika 1, shkronjat "c" dhe "ç", dhe pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.3, shkronja "b", nenit 34, pika 6, nenit 35, pika 4 dhe nenit 54, shkronja "b", nenit 55, pikat 3 dhe 6, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", ligjit nr. 115/2014, "Për ndarjen administrative-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ligjit nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për proçedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Udhëzimit nr.32, datë 31.12.2013 të Ministrit të Financave "Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël", me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK  
VENDOSI:

1. Miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore për Bashkinë Pogradec, si më poshtë:

**I. Taksat vendore**

**I.1 Taksa mbi pasurinë e paluajtshme**

Në taksat mbi pasurinë e paluajtshme përfshihen:

- Taksa mbi tokën bujqësore
- Taksa mbi ndërtesën
- Taksa mbi truallin

**I.1.1 Taksa mbi ndërtesat**



### 1. Taksa mbi ndërtesa që shërbejnë për banim:

Nr.	Kategoria e ndërtesave të banimit sipas ndarjes zonale Bashkin Pogradec	Taksa për lekë/m <sup>2</sup> sipërfaqe ndërtimi
1.2.1	<b>Ndërtesa banimi per qytetin Pogradec, fshati Tushemisht dhe fshati Buçimas:</b>	
1.2.1.1	Zona e qytetit ,fshati Tushemisht dhe fshati Buçimas	26.45
1.2.1.2	Zona e qytetit dhe fshati Tushemisht (për ndërtesat para vitit 1993)	18.51
1.2.2	<b>Ndërtesa banimi për Njësitë Administrative:</b>	
1.2.2.1	Njësitë Administrative Buçimas, Udënisht, Çerravë, Dardhas, Proptisht, Velçan dhe Trebinjë	12.33
1.2.2.2	Njësitë Administrative Buçimas, Udënisht, Çerravë, Dardhas, Proptisht, Velçan dhe Trebinjë (për ndërtesat para vitit 1993)	8.60

### 1. Taksa mbi ndërtesat që ushtrohet veprimtari ekonomike:

Kategoritë e ndërtesave për veprimtari ekonomike	Taksa për lekë/m <sup>2</sup> sipërfaqe ndërtimi	
	Qyteti Pogradec dhe Tushemisht	Njësitë e tjera administrative
a) Njësi tregtimi dhe shërbimi	194.61	134.73
b) Për parkim të mbuluar dhe bodrumet	90.82	62.87
c) Për parkim të hapur	38.92	26.95
ç) Për veprimtari industriale	64.87	44.91
d) Për veprimtari bujqësore dhe blektorale	38.92	26.95
dh) Rruga "Nehemia" OJF (vep. ekonomike jofitimprurëse)	73.35	

### Përfundime:

#### Përfundohen nga pagesa e taksës së ndërtesës:

- Pronat e shtetit dhe të njëjësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
- Pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
- Ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;



- ç) Banesat sociale në pronësi të bashkive;
- ç) Pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike,që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
- çb) Ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
- ç) Strukturat akomoduese "Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit,të cilët janë mbajtës të një me tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht si "brand name";
- ç) Ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë vetëm pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të paaftë për punë;
- ç) Ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
- ç) Ndërtesat kulturore,nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse.

### 2.2 Taksa mbi tokën bujqësore :

Niveli i taksës mbi tokën bujqësore, përcaktohet sipas Aneksit 1,bashkëlidhur Ligjit nr.9632,datë 10.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, Kategoria 3, si më poshtë:

Kategoritë mesatare të tokës bujqësore	Lekë/ha/vit
I	2 800
II	2 100
III	1 400
IV	1 350
V	1 150
VI	1 100
VII - X	1 000

Detyrimi për taksën mbi tokën bujqësore është vjetor. Detyrimi llogaritet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

#### Përjashtimi nga taksa mbi tokën bujqësore:

Përjashtohen nga taksa tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari ,për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.

### 2.2.3 Taksa mbi truallin :



Taksa mbi truallin	Njësia	Qyteti Pogradec	Njësitë e tjera Administrative
Për Familjet	lekë/m <sup>2</sup> /vit	0.28	0.20
Për Bizneset	lekë/m <sup>2</sup> /vit	15	12

Detyrimi për taksën mbi truallin është vjetor. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, kryen llogaritjen në bazë të sipërfaqes dhe vlerës së taksës sipas tabelës dhe klasifikimit më sipër. Vjelja bëhet nga Ujësjetllës Kanalizime Rajoni Pogradec sh.a, për familjet dhe subjektet që kanë kontratë me këtë shoqëri.

### 5.3 Taksa e fjetjes në hotel :

Kategoritë e Hoteleve	Njësia	Niveli i taksës së fjetjes në hotel
Hotele me 4 ose 5 yje	lekë/natë qëndrimi	175
Hotele deri në 3 yje, bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese, sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin	lekë/natë qëndrimi	70

Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të Bashkisë. Në faturën e hotelit shënohet çmimi i fjetjes dhe mbi të vlera e taksës. Detyrimi për llogaritjen e kësaj takse i takon Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, pranë Bashkisë Pogradec. Derdhja e shumës së taksës së mbledhur nga taksapaguesi për fjetjen në hotel, kalohet në llogari të Bashkisë Pogradec brenda datës 5 të muajit pasardhës.

*Taksa e fjetjes në hotel llogaritet jo më pak se 80 ditë kalendarike në vit për Hotelet .*

*Taksa e fjetjes në hotel llogaritet jo më pak se 45 ditë kalendarike në vit për Bujtinat .*

### 5.4 Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme:

Kategoritë e ndërtesave	Njësia	Shkalla e taksës për njësi
Ndërtesa banimi	Lekë/m <sup>2</sup>	300
Ndërtesa për tregji dhe shërbime, përfshirë dhe zyra	Lekë/m <sup>2</sup>	700
Ndërtesa të tjera	Lekë/m <sup>2</sup>	500

Llogaritja dhe vjelja e kësaj takse bëhet nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, e cila në rolin e agentit të taksave mban 3 % të shumës së arkëtuar.



### **Përfjashtimet:**

Përfjashtohen nga pagimi i taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme:

a. Enti Kombëtar i Bancave, Ministria e Financave dhe Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore e Qendrore;

b. Personat, të cilët janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat vetjake, në mbështetje të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar;

c. Subjektet që dhurojnë pasuri të paluajtshme kur përfitues të drejtpërdrejtë janë:

d. Institucionet dhe entet shtetërore e publike, qendrore e vendore;

e. Bashkësitë fetare ose organizatat jofitimprurëse, kur dhurimi lidhet me atë pjesë të veprimtarisë së tyre pa qëllim fitimi. Në këto raste dhuruesi, pasi ka marrë vërtetimin nga Këshilli Bashkiak për përfjashtimin nga taksa, bën regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të dhuruar. Në çastin e regjistrimit, dhuruesi paguan pjesën që i takon agjentit të taksave.

Në rastet kur pranohet nga vetë palët ose kur vërtetohet ligjërisht simulim i dhurimit për llogari të një shitjeje, për shmangie nga taksa, zbatohen taksa sa dyfishi i vlerës, pavarësisht nga përgjegjësitë e tjera sipas ligjeve në fuqi.

### **1.5. Taksa e tabelës:**

Lloji tabelës	Njësia	Bashkia Pogradec
<b>Takse tabelle për qëllime identifikimi, të trupëzuara ose jo, brenda territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve (ku shënohet emri dhe /ose aktiviteti i biznesit).</b>		
Deri në 2 m <sup>2</sup>	lekë/m <sup>2</sup> /vit	0
Mbi 2 m <sup>2</sup> deri 10 m <sup>2</sup>		
- E thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m <sup>2</sup> /vit	10 000
- Me ndriçim të thjeshtë	lekë/m <sup>2</sup> /vit	15 000
- Elektronike	lekë/m <sup>2</sup> /vit	20 000
Mbi 10 m <sup>2</sup> deri 20 m <sup>2</sup>		
- E thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m <sup>2</sup> /vit	8 500
- Me ndriçim të thjeshtë	lekë/m <sup>2</sup> /vit	12 750
- Elektronike	lekë/m <sup>2</sup> /vit	17 000
Mbi 20 m <sup>2</sup> deri 40 m <sup>2</sup>		
- E thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m <sup>2</sup> /vit	5 500
- Me ndriçim të thjeshtë	lekë/m <sup>2</sup> /vit	8 250
- Elektronike	lekë/m <sup>2</sup> /vit	11 000
Mbi 40 m <sup>2</sup>		
- E thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m <sup>2</sup> /vit	4 000
- Me ndriçim të thjeshtë	lekë/m <sup>2</sup> /vit	6 000



- Elektronike	lekë/m <sup>2</sup> /vit	8 000
Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formën e përmasat e tabelave për orientim.		
	lekë/m <sup>2</sup> /vit	120
Tabelë për qëllime reklamimi, e lëvizshme dhe e palëvizshme deri ne tavanin maksimal 35 m <sup>2</sup>		
- E thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m <sup>2</sup> /vit	22 500
- Elektronike	lekë/m <sup>2</sup> /vit	45 000
Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj.		
- Të të gjitha përmasave	lekë/m <sup>2</sup> /ditë	1 000

Detyrimi për llogaritjen dhe vjeljen e kësaj takse i takon Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore.

## II TARIFA VENDORE

Ky kapitull trajton tarifat vendore në mënyrë nominale duke u nisur nga elementët:

- Llojit, baza e taksueshmërisë, kategorizimet dhe nënkategorizimet, sipas të dhënave nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve, kështet e pagimit, koha e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

Në ndarjen sipas Zonave ne kemi përcaktuar dy zona ( bashkangjitur harta e qytetit):

- ✓ Zona A
- ✓ Zona B

Në **Zonën A** (skica bashkangjitur) përfshihen edhe bizneset që zhvillojnë aktivitetet në Rrugët Kryesore të qytetit:

- Rruga "Kajo Karafili"
- Rruga "Reshit Collaku" 1 dhe 2
- Rruga "10 Dëshmorët e Pojskës"
- Rruga "Islam Dani"
- Rruga "Rinia"
- Rruga "Naim Frashëri"
- Rruga "Gani Butka"
- Rruga e "Korçës"
- Rruga "Abdul Frashëri"
- Rruga "Industriale"
- Rruga "Fan Noli"

Në **Zonën B** përfshihen bizneset që zhvillojnë aktivitet në pjesën që nuk përfshihen në zonën A.



## Përrjashtime dhe lehtësime:

- Përrjashtohen nga pagesa e tarifave të pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit OJF-të.
- Përr bizneset e reja, të cilat punësojnë mbi 25 punonjës dhe bizneset e reja që hapen nga individë deri në moshën 25 vjeçare, tarifat vendore reduktohen në masën 25 % në vitin e parë të aktivitetit.
- Përr bizneset e reja, të cilat administrohen nga gratë, tarifat vendore reduktohen në masën 20% përr vitin e parë.
- Bizneset që zhvillojnë aktivitet përr punime artizanale përrjashtohen nga tarifat.
- Përr familjet që janë në ndihmë ekonomike dhe pensionistët e vetmuar paguajnë 70% të tarifave.
- Gratë kryefamiljare të cilat nuk janë në marrëdhënie pune dhe pensionistet vetëm, pa bashkëshortin/bashkëshorten, përrjashtohen nga pagesa e tarifave vendore.
- Nuk do të paguhet tarifa në fshatrat e Njërive Administrative, në të cilat është e pamundur të ofrohet shërbimi i pastrimit, përr shkak të infrastrukturës.
- Qytetarë të cilët kanë gjëndjen civile në Bashkinë Pogradec, nuk kanë shtëpi banimi në pronësi të tyre dhe nuk janë rezidentë në Pogradec përrjashtohen nga pagesa e tarifave vendore.

## II.1 Tarifa e pastrimit

### II.1.1 - Përr Familjet :

Kategoritë	Njësia	Pogradec	Buçimas Udënisht	Çerravë	Nj. Adm të tjera
- Përr çdo banesë në Bashkinë Pogradec	lekë/vit	3 200	3 200	2 200	800
- Përr çdo shtëpi banimi me oborr në territorin e Bashkisë Pogradec (ritje 25%) oborri i të cilës është më pak 100 m <sup>2</sup>	lekë/vit	4 000	4 000	2 750	1 000
- Përr çdo shtëpi banimi me oborr në territorin e Bashkisë Pogradec (ritje 50%) oborri i të cilës është më shumë se 100 m <sup>2</sup>	lekë/vit	4 800	4 800	3 300	1 200

### II.1.2 Tarifa e pastrimit përr Bizneset

Tarifa e pastrimit përr biznesin përrcaktohet sipas kategorive të mëposhtme:

#### A. Tarifë pastrimi përr biznesin me xhiro nga 0-3 milion lekë :



Kategoritë e Biznesit	Njësia	Zona A	Zona B Pogradec	Buçimas, Udënisht	Çërravë	Të tjera
Ushqimore (shumicë)	lekë/vit	13 800	13 800	13 200	10 200	1 080
Ushqimore (pakicë)	lekë/vit	12 000	9 000	8 400	6 000	1 080
Prodhim (punime mobilerie punime druri,punime mermeri,fara e fidane,rritje shpendesh,rritje peshku,etj) prerje dhe tregtim dru zjarri.	lekë/vit	17 400	17 400	17 400	17 400	17 400
Shërbime	lekë/vit	7 000	5 500	5 000	4 500	900
Industriale,peripto	leke/vit	7 000	5 500	5 000	4 500	900
Bar-Restorant, Hotele, Agrobiznes,fast-food	lekë/vit	18 000	18 000	17 400	12 600	1 080
Pyrektore	lekë/vit	10 000	7 500	7 000	5 000	900
Bar-Kafe	lekë/vit	15 000	13 800	13 200	7 800	960
Profesione të Lira: Avokat Noter,Arkitekt,Inxhinier, Projektues,Ekonomist Agronom,Ekspert Kontabël.	lekë/vit	12 500	12 500	12 500	12 500	12 500
Profesione të Lira: Mjek i Specializuar, Stomatolog, Stomatolog i Specializuar Farmacist, Infermier,Etj.	lekë/vit	20 000	20 000	20 000	20 000	20 000
Subjekte Ambulante me NIPT.	lekë/vit	7 000	5 500	5 000	3 500	0
Tregtim mish, peshk, bulmet,sallameri.	lekë/vit	11 500	8 500	8 000	6 500	300
Tregu i lirë fruta-perime të miratuar nga Bashkia (për çdo tregtar).	lekë/m <sup>2</sup> /ditë	50	50	50	30	20
Për çdo subjekt ndërtimi shërbime në ndërtim. materialesh inerte, miniera me aktivitet në territorin e qytetit/Nj.A	lekë/vit	30 000	30 000	30 000	30 000	30 000

8. Tarifë pastrimi për biznesin me xhiro nga 3-5 milion lekë :





Kategoritë e Biznesit	Njësia	Zona A	Zona B Pogradec	Buçimas, Udënisht	Çërravë	Të tjera
Ushqimore (shumicë)	Lekë/vit	20 400	20 400	19 800	17 400	1 320
Ushqimore (pakicë)	Lekë/vit	16 500	12 000	11 400	9 000	1 320
Prodhim (punime mobilerie punime druri,punime mermeri,fara e fidane,rritje shpendesh,rritje peshku,etj)	Lekë/vit	25 800	24 000	23 400	21 000	1 320
Chërbime	Lekë/vit	9 200	7 000	6 500	4 500	1 100
Industriale, peripto	Lekë/vit	9 200	7 000	6 500	4 500	1 100
Bar-Restorant, Hotele, Agrobiznes,fast-food	Lekë/vit	23 700	23 100	22 500	20 100	1 320
Dyrektore	Lekë/vit	13 750	10 000	9 500	7 500	1 100
Bar-Kafe	Lekë/vit	18 240	15 600	15 000	12 600	1 320
Profesione të Lira: Avokat,Noter,Arkitekt, Inxhinier,Projektues, Ekonomist,Agronom, Ekspert Kontabel.	Lekë/vit	14 500	14 500	14 500	14 500	14 500
Profesione të Lira: Mjek i Specializuar, Stomatolog i Specializuar, Farmacist, Infermjer,Etj.	Lekë/vit	22 000	22 000	22 000	22 000	22 000
Tregtim mish, peshk, bulmet,sallameri	Lekë/vit	15 000	11 500	11 000	9 000	1100
Për çdo subjekt ndërtimi, chërbime në ndërtim materialesh inerte, miniera me aktivitet në territorin e shtetit/Nj.A	Lekë/vit	35 000	35 000	35 000	35 000	35 000

C. Tarifë pastrimi për biznesin me xhiro nga 5-8 milion lekë:



Kategori e Biznesit	Njësia	Zona A	Zona B Pogradec	Buqimas, Udënisht	Çerravë	Të tjera
Ushqimore (shumicë)	Lekë/vit	27 000	27 000	26 400	24 000	2 640
Ushqimore (pakicë)	Lekë/vit	21 000	15 000	14 400	12 000	2 640
Prodhim (punime mobilerie,punime druri,punime mermeri,lara e fidane,rritje shpendesh,rritje peshku,etj)	Lekë/vit	33 000	33 000	32 400	30 000	2 640
Shërbime	Lekë/vit	11 500	8 500	8 000	6 000	2 200
Industriale, peripto.	Lekë/vit	11 500	8 500	8 000	6 000	2 200
Bar-Restorant, Hotele, Agrobiznes,fast-food.	Lekë/vit	29 400	28 200	27 600	25 200	2 400
Dyrektoare	Lekë/vit	17 500	12 500	12 000	10 000	2 200
Bar-Kafe	Lekë/vit	21 000	17 400	16 800	14 400	2 400
Profesione të Lira: Avokat,Noter,Arkitekt, Inzhinier,Projektues, Ekonomist,Agronom, Ekspert Kontabel.	Lekë/vit	16 500	16 500	16 500	16 500	16 500
Profesione të Lira: Mjek i Specializuar, Stomatolog i Specializuar,Farmacist, Infermier,Etj.	Lekë/vit	24 000	24 000	24 000	24 000	24 000
Uregtimit mish, peshk, bulmet,sallameri.	Lekë/vit	20 500	16 500	14 000	12 000	1 200
Për çdo subjekt ndërtimi, shërbime në ndërtim. materialesh inerte, miniera me aktivitet në territorin e qytetit/Nj.A	Lekë/vit	40 000	40 000	40 000	40 000	40 000

#### D. Tarifë pastrimi për biznesin me xhiro nga 8-14 milion lekë:



Kategoritë e Biznesit	Njësia	Pogradec	Buçimas Udënisht	Çërrave	Nj.A Tjera
Tarifë për subjekte tregëtimi, shërbimi, kompani celulare	lekë/vit	65 000	60 000	25 000	20 000
Tarifë për subjekte bar-restorant hotel, supermarket,ushqimore me shumice, karburant.	lekë/vit	78 000	72 000	30 000	24 000
Tarifë për subjekte furrë buke	lekë/vit	65 000	60 000	25 000	20 000
Tarifë për subjekte furrë buke me adrese dytësore ne Bashkinë Pogradec	lekë/vit	35 000	30 000	12 500	10 000
Tarifë për njësi prodhimi (materialesh inerte, miniera me aktivitet në territorin e qytetit/Nj.A).	lekë/vit	200 000	200 000	200 000	200 000
Tarifë për njësi prodhimi në territorin e qytetit /njësi administrative(punime mobilerie punime druri,punime mermeri,fara e lidane,ritje shpendesh,ritje peshku,fason,	lekë/vit	100 000	100 000	60 000	40 000
Tarifë për çdo subjekt ndërtimi shërbime në ndërtim	lekë/vit	130 000	130 000	130 000	130 000
Tarifë shitesë: Çdo objekt për ndërtim, në vitin e parë në momentin e zbardhjes së lejës	lekë/m <sup>2</sup> /vit	30	30	15	15
Tarifë për objekt në ndërtim, infrastrukturë në vitet pasardhës	lekë/vit	120 000	120 000	50 000	25 000
Tarifë për çdo ndërmarrje Sh.A.	lekë/vit	140 000	140 000	140 000	140 000
Tarifë për çdo ndërmarrje Sh.A. me vendndodhje dytësore brenda Bashkisë Pogradec	lekë/vit	100 000	100 000	100 000	100 000
Tarifë për bankat	lekë/vit	75 000	70 000	60 000	60 000
Tarifë për "Shoqëri kursim krediti", agjensi udhëtimesh.	lekë/vit	35 000	30 000	25 000	25 000
Tarifë për pikë floto	lekë/vit	65 000	60 000	35 000	30 000
Tarifë për agjensi sigurimesh	lekë/vit	50 000	45 000	20 000	20 000
Tarifë për subjektet që kanë konçensione,Hec.	lekë/vit	150 000	150 000	150 000	150 000

**C. Tarifë pastrimi për biznesin me xhiro mbi 14 milion lekë:**



Kategoritë e Biznesit	Njësia	Pogradec, Buçimas, Udënisht, Çërravë, Proptisht, Velçan, Dardhas, Trebinjë
Tarifë për subjekte tregtimi, shërbimi, kompani celulare	lekë/vit	80 000
Tarifë për subjekte bar-restorant hotel, supermarket, ushqimore me shumicë, karburant.	lekë/vit	96 000
Tarifë për subjekte furrë buke	lekë/vit	80 000
Tarifë për subjekte furrë buke me adrese dytësore në Bashkinë Pogradec	lekë/vit	40 000
Tarifë për njësi prodhimi (materialesh inerte, miniera me aktivitet në territorin e qytetit/Nj.A).	lekë/vit	250 000
Tarifë për njësi prodhimi në territorin e qytetit /njësi administrative (punime mobilerie punime struri, punime mermeri, fara e fidane, rritje shpendesh, rritje peshku, fason, etj)	lekë/vit	150 000
Tarifë për çdo subjekt ndërtimi, shërbime në ndërtim.	lekë/vit	150 000
Tarifë shtesë: Çdo objekt për ndërtim, në vitin e parë në momentin e zbardhjes së lejës	lekë/m <sup>2</sup> /vit	30
Tarifë për objekt në ndërtim, infrastrukturë në qytet pasardhës	lekë/vit	150 000
Tarifë për çdo ndërmarrje Sh.A.	lekë/vit	150 000
Tarifë për çdo ndërmarrje Sh.A. me vendndodhje dytësore brenda Bashkisë Pogradec	lekë/vit	120 000
Tarifë për bankat	lekë/vit	85 000
Tarifë për "Shoqëri kursim krediti", agjensi ndhëtimesh	lekë/vit	45 000
Tarifë për pikë lloto	lekë/vit	85 000
Tarifë për agjensi sigurimesh	lekë/vit	60 000
Tarifë për subjektet që kanë konçensione, Hec.	lekë/vit	250 000

#### F. Tarifë pastrimi për transportin :

Kategoritë e Biznesit	Njësia	Pogradec, Buçimas Udënisht	Çërravë	Nj.A Tjera
Tarifë për transport udhëtarësh, mallrash	lekë/mjet/vit	5 000	2 500	1 000

#### G. Tarifë pastrimi për çdo dhomë hoteli, moteli, kompleksi turistik :



Kategoritë e Biznesit	Njësia	Pogradec, Buçinas Udënisht
Tarifë për çdo dhomë hoteli, moteli, kompleksi turistik	lekë/vit/dhomë	400

### 13. Tarifë pastrimi të tjera:

Tarifë pastrimi të tjera	Njësia	Pogradec, Buçinas, Udënisht	Çërravë	Të tjerat
Tarifë për çdo dhomë shtëpi pushimi, spitali, materniteti		300	300	300
Tarifë për mjedise administrative (zyra, salla mbledhjeje)	lekë/zyrë/vit	2 500	2 500	2 500
Tarifë për njësi magazinimi mallrash industriale	lekë/njësi/vit	5 000	2 000	1 000
Tarifë për njësi magazinimi mallrash shqimore	lekë/njësi/vit	10 000	4 000	2 000
Tarifë për çdo subjekt tregtar tek tregu i miratuar nga Bashkia	lekë/njësi/vit	2 000	1 000	1 000
Tarifë për çdo subjekt tregtar i pajisur me lejë sezonale	lekë/njësi/lejë	2 000	1 000	1 000

Detyrimi për llogaritjen tarifës të pastrimit i takon Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore. Vjelja e kësaj tarife për familjet dhe bizneset me kontratë me Ujësjetllës Kanalizime Rajoni Pogradec sh.a, bëhet nga kjo shoqëri. Për Bizneset pa kontratë me Ujësjetllës Kanalizime Rajoni Pogradec sh.a, vjelja bëhet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, nëpërmjet Postës Shtetërore ose Bankave të Nivelit të II-të.

### U.2 Tarifa e gjelbërimit:

**Kjo Tarifë llogaritet në nivelin 50 % (për qind) të Tarifës së Pastrimit.**

#### Përfshirje:

Përfshihen nga pagesa e kësaj tarife familjet e Njësive Administrative Dardhas, Proptisht, Trebinjë dhe Velçan.

Kategoritë	Njësia	Pogradec, Tushemisht	Buçinas, Udënisht	Çërravë	Nj.A Tjera
------------	--------	-------------------------	----------------------	---------	---------------



Tarifë për familje	lekë/vit/familje	50 % (për qind) të Tarifës së Pastrimit për objekte pa oborr	50 % (për qind) të Tarifës së Pastrimit për objekte pa oborr	50 % (për qind) të Tarifës së Pastrimit për objekte pa oborr	0
Tarifë për biznes	lekë/vit	50 % (për qind) të Tarifës së Pastrimit	50 % (për qind) të Tarifës së Pastrimit	50 % (për qind) të Tarifës së Pastrimit	0

Detyrimi për llogaritjen e kësaj tarife i takon Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore. Vjelja e kësaj tarife për familjet dhe bizneset me kontratë me Ujësjetllës Kanalizime Rajoni Pogradec sh.a, bëhet nga kjo shoqëri .Për Bizneset pa kontratë me Ujësjetllës Kanalizime Rajoni Pogradec sh.a, vjelja bëhet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nëpërmjet Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të II-të.

### 3.3 Tarifa e ndriçimit:

Kategoritë	Njësia	Pogradec, Tushemisht	Buçimas, Udënisht	Çërravë	Nj.A Tjera
Tarifë për Familjet	lekë/vit/familje	1 500	1 500	1 500	1 000
Tarifë për çdo biznes me xhiro 0-3 milion lekë	lekë/vit	3 000	3000	3000	1 500
Tarifë për çdo biznes me xhiro 3-8 milion lekë	lekë/vit	4 000	4 000	4 000	3 000
Tarifë për çdo biznes me xhiro 8-14 milion lekë	lekë/vit	8 000	8 000	8 000	8 000
Tarifë për çdo biznes me xhiro mbi 14 milion lekë	lekë/vit	12 000	12 000	12 000	12 000
Tarifë për institucione shtetërore	lekë/vit	15 000	15 000	15 000	15 000
Tarifë për transport udhëtarësh	lekë/vit	2 000	2 000	2 000	2 000
Tarifë për subjektet ambulante me NIPT, subjekt tregtar tek tregu i miratuar nga Bashkia dhe çdo subjekt tregtar i pajisur me lehtë sezonale	lekë/vit	3 000	3 000	3 000	3 000



Detyrimi për llogaritjen e kësaj tarife i takon Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore. Vjelja e kësaj tarife për familjet dhe bizneset me kontratë Ujësjetllës Kanalizime Rajoni Pogradec sh.a, bëhet nga kjo shoqëri . Për Bizneset pa kontratë me Ujësjetllës Kanalizime Rajoni Pogradec sh.a , vjelja bëhet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nëpërmjet Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të II-të.

#### II.4 Tarifa e Mirëmbajtjes së Varrezave Publike:

Kategoritë	Njësia	Bashkia Pogradec
Tarifë për çdo familje	lekë/vit	500

Detyrimi për llogaritjen e kësaj tarife i takon Drejtorisë të Taksave dhe Tarifave Vendore. Vjelja e kësaj tarife për familjet dhe bizneset me kontratë me Ujësjetllës Kanalizime Rajoni Pogradec sh.a, bëhet nga kjo shoqëri. Për Bizneset pa kontratë me Ujësjetllës Kanalizime Rajoni Pogradec sh.a, vjelja bëhet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nëpërmjet Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të II-të.

#### II.5 Tarifë për shfrytëzim të automjetit tip "Kosh" :

Kategoritë	Njësi	Pogradec, Tushemisht	Buçimas Udënisht	Nj.A të tjera
Tarifë për shfrytëzim të automjetit tip "Kosh"	lekë/orë	2 200	2 200	2 200

Detyrimi për llogaritjen dhe vjeljen e kësaj tarife i takon Degës Ekonomike të Ndërmarrjes të Mirëmbajtjes së Infstrukturës dhe Punëve Publike.

#### II.6 Tarifa e Shfrytëzimit të Sipërfaqeve Publike:

Kjo Tarifë është sezonale dhe në të përfshihet zënia e hapësirave publike.

Kategoritë	Njësia	Pogradec Zona A Lulishte	Pogradec Zona B Bul. "10 D. e Poj, Europa, sheshi i Bash Tushemisht	Zona pas vilave	Zona të tjera



1. Hapësirë publike për qëllime biznesi jashtë vendit të regjimit, tavolina, sipërfaqe të rrethuara me vazo dekorative, hangjella, drurë, kufizime me plasmasë dhe sende të ngjashme me to.	lekë/m <sup>2</sup> /muaj	1000	500	300	400
<b>Kategoritë</b>	<b>Njësia</b>	<b>Në të gjithë vijën liqenore Pogradec</b>			
2. Tarifë e hapësirës publike për qëllime biznesi për vendosje shezllonash në plazh publik (për sezonin turistik do paguhet vetëm për 45 ditë)	lekë/m <sup>2</sup> /muaj	300			
<b>Kategoritë</b>	<b>Njësia</b>	<b>Pogradec</b>	<b>Rr. Volorek-Tushemisht</b>	<b>Udënisht</b>	
3. Tarifë për strukturat e vendosura nga Bashkia në rregun e miratuar për periudhën (korrik-gusht)	lekë/muaj	20 000	15 000	10 000	0
4. Tarifë për strukturat e vendosura nga Bashkia në rregun e miratuar për periudhën e mbetur	lekë/muaj	10 000	7 500	5 000	0
5. Tarifë për vendosje mjete tundraese jo motorike në plazh publik (jo më pak se 90 ditë)	lekë/ditë	200	200	200	0
6. Tarifë për vendosje mjete tundraese motorike në plazh publik (jo më pak se 90 ditë)	lekë/ ditë	500	500	500	0
<b>Kategoritë</b>	<b>Njësia</b>	<b>Pogradec Zona A Bul. "10 D. e Poj</b>	<b>Pogradec rruga "Ismail Qemali" Rr. Volorek-Tushemisht</b>	<b>Udënisht</b>	
7. Tarifë e hapësirës publike për leajat e dhëna përgjate vijës bregliqenore për lojra femijësh dhe lojërat e vendosura në ujë.	lekë/muaj	250	150	100	0

Detyrimi për llogaritjen dhe vjeljen e kësaj tarife i takon Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore nëpërmjet Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të II-të.





### 11.7 Tarifa për linjat ajrore dhe nëntokësore:

(Sistemit, Transmetimet Televizive, Telefon, Internet)

(Sistemit, Transmetimet Televizive, Telefon, Internet)

Kategoritë	Njësia	Pogradec	Buçimas	Udënisht	Nj.A e tjera
Tarifa për linjat ajrore dhe nëntokësore (Sistemit Kabllor, Transmetimet Televizive, Telefon, Internet)	lekë/vit	250 000	200 000	150 000	100 000

Detyrimi për llogaritjen dhe vjeljen e kësaj tarife i takon Drejtorisë të Taksave dhe Tarifave Vendore nëpërmjet Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të II-të.

### 11.8 Tarifa e pagesave për Liçensa, Çertifikata për Transport Rrugor, aplikohen sipas pasqyrës së miratuar me shkresën e Ministrisë së Financave nr.13786/1 datë 27.01.2010.

Detyrimi për llogaritjen e kësaj tarife i takon Sektorit të Transportit dhe vjelja bëhet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

### 11.9 Tarifa e parkimi për mjetet e liçensuara dhe tarifa për parkimin e automjeteve në vendparkime publike me pagesë:

#### 11.9.1 Tarifë për parkimin për çdo mjet të liçensuar :

Kategoritë	Njësia	Tarifa
Tarifë për autobuza 25+1 vende	Lekë/vit/mjet	19 500
Tarifë për autobuza 15+1 deri në 25+1 vende	Lekë/vit/mjet	15 600
Tarifë për autobuza 9+1 deri 14+1 vende	Lekë/vit/mjet	11 700
Tarifë për autoveturë taxi 8+1 vende	Lekë/vit/mjet	7 800
Tarifë për autoveturë taxi 6+1 vende	Lekë/vit/mjet	5 800
Tarifë për autoveturë ëtaxi 4+1 vende	Lekë/vit/mjet	3 900
<b>Tarifë parkimi për automjete transporti mallrash që liçensohen, ose çertifikohen</b>		
<b>Tarifë për Kamionë</b>	<b>Njësia</b>	<b>Tarifa</b>
• Me kapacitet maksimal transportues deri në 3,5 ton	Lekë/vit/mjet	3 900
• Me kapacitet maksimal transportues 3,5 deri në 8 ton	Lekë/vit/mjet	5 800
• Me kapacitet maksimal transportues 8 deri në 14 ton	Lekë/vit/mjet	7 800
• Me kapacitet maksimal transportues mbi 14 ton	Lekë/vit/mjet	9 700



Detyrimi për llogaritjen e kësaj tarife i takon Sektorit të Transportit dhe vjelja bëhet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, nëpërmjet Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të II-të.

**11.9.2 Tarifa e parkimit për mjetet që çertifikohen për transport udhëtarësh për llogari të vet, të cilët nuk kanë stacion qëndrimi me pagesë:**

**Tabela e mëposhtme:**

Kategoritë	Njësia	Tarifa
Tarifë për autobuza 25+1 vende	Lekë/vit/mjet	5 000
Tarifë për autobuza 15+1 deri në 25+1 vende	Lekë/vit/mjet	4 000
Tarifë për autobuza 9+1 deri 14+1 vende	Lekë/vit/mjet	2 000
Tarifë për mikrobuza taxi 8+1 vende	Lekë/vit/mjet	1 000

Detyrimi për llogaritjen e kësaj tarife i takon Sektorit të Transportit dhe vjelja bëhet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nëpërmjet Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të II-të.

**11.9.3 Tarifë parkimi në vendparkime publike me pagesë / transport udhëtarësh :**

Kjo tarifë do të zbatohet në **zonën A** dhe në fshatin **Tushemisht** të NJA Buçimas:

Tarifë parkimi në vendparkime publike me pagesë/transport udhëtarësh	Njësi	Tarifa
Tarifë për autobuza 25+1 vende	Lekë/orë	150
Tarifë për autobuza 15+1 deri në 25 vende	Lekë/orë	100
Tarifë për autobuza 9+1 deri 14+1 vende	Lekë/orë	100
Tarifë për autoveture 8+1 vende	Lekë/orë	50
Tarifë për autoveture 6+1 vende	Lekë/orë	50
Tarifë për autoveture 4+1 vende	Lekë/orë	50
Tarifë për parkim të rezervuar automjeti për subjekte	Lekë/Vit	36000
Tarifë për parkim për banorët rezidente pranë banksës së tyre	Lekë/ Vit	1000
Tarifë për parkim për automjetet që qëndrojnë në afërsi të Tregjeve të inrituara nga NJA Çerravë dhe Proptisht	Lekë/muaj	200

Detyrimi për llogaritjen e kësaj tarife i takon Sektorit të Transportit dhe vjelja bëhet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nëpërmjet Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të II-të.



#### II.9.4. Tarifë parkimi tek terminali i autobusave:

Tarifë parkimi në vendparkime ne terminalin	Njësi	Tarifa
Tarifë për autobuza 25+1 vende	Lekë/orë	200
Tarifë për autobuza 9+1 deri 25+1 vende	Lekë/orë	150
Tarifë për autoveture 8+1 vende për mjete në linja rrethqytetëse	Lekë/orë	100

Detyrimi për llogaritjen e kësaj tarife i takon Sektorit të Transportit dhe vjelja bëhet punonjësi i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore.

#### II.9.5. Tarifa për librat e udhëtimit për shërbime turistike / të rastit të udhëtarëve brenda vendit :

Tarifa për librat e udhëtimit	Njësi	Tarifa
Libri i udhëtimit me 25 fletë me ngjyrë të gjelbër e lehtë	Lekë/libër	12.500

Detyrimi për llogaritjen e kësaj tarife i takon Sektorit të Transportit dhe vjelja bëhet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nëpërmjet Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të II-të.

#### II.10 Tarifat për Shërbimet në Bashkinë Pogradec:

Tarifë për Shërbimet	Njësia	Pogradec, Buçimas, Udënisht	NJA tjera
Tarifë për vërtetim që jepet nga arkivi i Bashkisë	Lekë	200	50
Tarifë për fotokopje të dokumentave të arkivit (për private), nën 5 faqe	Lekë	200	0
Tarifë për fotokopje të dokumentave të arkivit (për private) mbi 5 faqe (+10 lekë për çdo faqe shtesë)	Lekë	200	0
Tarifë për studimin e dokumentave të arkivit (për private)	Lekë	300	0
Tarifë për dhënien e formularit të lejës dhe certifikatës së transportit të mallrave	Lekë	200	0

Detyrimi për llogaritjen e kësaj tarife i takon Drejtorive përkatëse që ofrojnë shërbimin ,ndërsa vjelja e këtij detyrimi kryhet nëpërmjet Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të II-të.

#### II.11 Tarifat për Dhënie Lejë për Ushtrim Aktiviteti :

Të gjitha Lejat do të jepen në bazë të kërkesës me shkrim nga i interesuari.



Kategoria	Njësia	Pogradec	Buçimas, Udënisht	Çërravë	NJA të tjera
Tarifë për zgjatje orari të kohës normale të punës për Bar-Bufe, Restorante, Pub & Disko	Lekë/muaj	5 000	5 000	0	0
Tarifë për zgjatje orari të kohës normale të punës për Lojra e Fatit	Lekë/muaj	10 000	10 000	0	0
Tarifë për leje veprimtarie 24 orë për Bar-Bufe, Resorantr, Pub & Disko	Lekë/muaj	8 000	8 000	0	0
Tarifë për autorizim për pikë shitje lëndë djegëse për nevoja familjare	Lekë/muaj	5 000	2 000	1 000	0
Tarifë Servis, riparim mjetesh (transporti), Shërbim Rimorkim mjetesh të difektuara në rrugë, Shërbim Lavazh mjetesh, Gomisteri.	Lekë/muaj	5 000	5 000	5 000	3 000

Detyrimi për llogaritjen dhe vjeljen e kësaj tarife bëhet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nëpërmjet Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të II-të.

### 11.11.1 Tarifat për dhënie e Liçensave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj :

